

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitet 1991

Lënda Nr. IT-04-84-A

Data: 9 shkurt 2009

Origjinali: anglisht

KRYETARI I TRIBUNALIT NDËRKOMBËTAR

Para: Gjykatësit Patrick Robinson, Kryetar

Ushtruesi i: Z. John Hocking
Detyrës së Sekretarit

Urdhër i datës: 9 shkurt 2009

PROKURORI

kundër

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

PUBLIK

**URDHËR PËR ZËVENDËSIMIN E NJË GJYKATËSI NË NJË ÇËSHTJE PARA
DHOMËS SË APELIT**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Serge Brammertz

Avokatëve të të Akuzuarve:

Z. Ben Emmerson QC, Z. Rodney Dixon dhe Zj. Susan L. Park për Z. Ramush Haradinaj
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Collen Rohan për Z. Idriz Balaj
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Z. Lahi Brahimaj

UNË, PATRICK ROBINSON, Kryetar i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (“Tribunali Ndërkombëtar”);

DUKE MARRË SHËNIM “Urdhrin për Caktimin e Gjykatësve në një Çështje Para Dhomës së Apelit”, lëshuar prej Kryetarit të Tribunalit Ndërkombëtar më 6 maj 2008;

DUKE MARRË SHËNIM zgjedhjen e Gjykatësit Mohamed Shahabbuddeen në funksionin e Gjykatësit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare duke filluar prej 11 marsit 2009;

DUKE MARRË SHËNIM se bazuar në Rregullën 19 të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit Ndërkombëtar, Kryetari i Tribunalit bashkërendon punën e Dhomave;

DUKE MARRË PARASYSH paragrafin 3 të Nenit 12 dhe paragrafin 2 të Nenit 14 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar;

DUKE MARRË PARASYSH përbërjen e Dhomës së Apelit të Tribunalit Ndërkombëtar siç përcaktohet në dokumentin IT/261 lëshuar më 17 nëntor 2008;

DUKE MARRË PARASYSH nevojat administrative të Tribunalit Ndërkombëtar;

VETËCAKTOHEM efektivisht që prej këtij momenti në vend të Gjykatësit Mohamed Shahabbuddeen në Trupin Gjykses të kësaj çështjeje, dhe;

URDHËROJ efektivisht prej këtij momenti që Trupi Gjykses në çështjen *Prokurori. k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-A, të ketë përbërjen e mëposhtme:

Gjykatës Patrick Robinson, Kryegjykatës

Gjykatës Fausto Pocar

Gjykatës Andrézia Vaz

Gjykatës Liu Daqun

Gjykatës Theodor Meron

Përpiluar në anglisht dhe frengjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Patrick Robinson
Kryetar

Sot, më datën 9 shkurt 2009.
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]